

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Departamenti	Departamenti i Agroekonomisë
Programi i Studimeve	Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit
Titulli i lëndës:	Tregjet Ndërkombëtare dhe Politikat e Tregtimit
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	E rregullt
Viti i studimeve:	I (parë)
Semestri	Semestri I
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	Rr. “Bill Clinton” p.n.,10000 Prishtinë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi
Detajet kontaktuese:	Emali: njazi.bytyqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda përbëhet nga dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ekonomia e tregtisë ndërkombëtare dhe Politikat e tregtisë ndërkombëtare. <p>Në këtë lëndë, do të diskutohet mbi arsyet (faktorët) që motivojnë tregtinë në mallra. Në këtë kontekst, do të diskutohet mbi modelet me të rëndësishme të tregtisë, të tilla si modeli i gravitetit, modeli rikardian, modeli i faktorëve të prodhimit, dhe modelin standard të tregtisë. Pas modeleve të tregtisë, diskutohet mbi ekonomitë e shkallës dhe tregtinë, lëvizshmërinë e faktorëve të prodhimit dhe tregtinë, etj. Në kurs, është përfshirë dhe diskutimi mbi politikat që bëjnë vendet e ndryshme për të influencuar këtë lloj tregtie, të tilla si tarifatat, subvencionin e eksporteve, kuotat dhe kuotat tarifore, etj. Lënda përmban edhe diskutime mbi ekonominë politike dhe të politikave të tregtisë, efektet rishpërndarës të tregtisë, integrimin ekonomik shumëpalësh dhe dy palesh, ndihmën për tregtinë, etj.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Që studentet:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përmirësimi i kuptueshmërisë së studenteve mbi motivet se pse kombet tregtojnë; evidentimi i përfitimeve nga tregtia; Rritja e kapaciteteve të analizës mbi efektet e politikave tregtare të qeverive;

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të suksesshëm të kësaj lënde studenti/a do të jetë në gjendje të analizoj tregun ndërkombëtar të ushqimit dhe politika e tregtimit të produkteve nëpër vende të ndryshme të botës.</p> <p>Studentet do të krijojnë bazën e njohurive të veta mbi tregjet ndërkombëtare dhe politikat e tregtimit si dhe tregtimin e produkteve dhe shërbimeve nga një vende në një vend tjetër:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Njoh rëndësinë e tregut ndërkombëtar të ushqimit 2. Njoh teorinë merkanteliste të tregut ndërkombëtar; 3. Njoh teorinë relative të tregut ndërkombëtar 4. Njoh teorinë absolute të tregut ndërkombëtar; 		
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsejtë/orë
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	-	-	-
Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	3	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiime,seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	2	3	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	3	6	18
Projektet, prezantimet, etj	2	11	22
Totali			175
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia dhe mësim-nxënia në këtë lëndë bazohet në ligjërata, punë individuale, ushtrime, plan biznesi, kollokfiimi (2), ese, diskutime, punë grupore.		
Metodat e vlerësimit:	Studentet duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë njohuritë e fituara gjatë kursit. Vlerësimi i studentëve si me poshtë.		

	Kollokfiumi i parë/Vlerësimi i parë: 35% Kollokfiumi i dytë/Vlerësimi i dytë: 35% Pjesëmarrja në Ligjërata, ushtrime dhe Aktivitete 15% Punim Detyre 15% Total 100%
Literatura bazë:	Literatura e obliguar: <ol style="list-style-type: none"> 1. Njazi Bytyqi, Tregjet Ndërkombëtare dhe Politikat e Tregtimit, Ligjërata të Autorizuara, (Ligjërata të Autorizuara në dorëshkrim, studentet do ta marrin materialin pas perëndimit të çdo ligjërata. Prishtine, 2023. 2. Engjell Skreli, Tregtia Ndërkombëtare, prezantime në power point, 2022. 3. Ahmet Mançellari, Tregtia Ndërkombëtare – Teoria dhe Politika, Botimi i dytë (Ripunim), 1999.
Literatura shtesë:	Literaturë Shtesë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Jim Sherlock and Jonathan Reuvid; the Handbook of International Trade; Second European Edition; 2008.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	
Java e parë:	Tema 1: Permbajtja e lendes, kerkesat e pranimit, politika e vleresimit - Njohja me programin e lendes: kushtet e pranimit, pjesët kapitujt dhe temat, objektivat, metodat e mësimit, politikat e vlerësimit
Java e dytë:	Tema 2: Hyrje në tregtinë botërore - Tregtia ndërkombëtare si pjesë e ekonomiksit ndërkombëtar, përfitimet nga tregtia, shpjegimi i modeleve të tregtisë, efektet e politikave qeveritare mbi tregtinë. partneret me të mëdhenj tregtare të tregtare të Kosovës, modeli i gravitetit, kufijtë dhe marrëveshjet tregtare, globalizimi, ndryshimi i përbërjes së tregtisë, korporatat shumëkombëshe.
Java e tretë:	Tema 3: Modeli rikardian i tregtisë - Modeli Rikardian (modeli, kurba e mundësisë së prodhimit, kosto e oportunitetit, prodhimi, çmimet dhe pagat); tregtia në modelin rikardian: avantazhi i krahasuar (avantazhi i

	krahasuar, oferta e krahasuar, përfitimet nga tregtia në modelin rikardian); pagat e krahasuara, produktiviteti dhe tregtia (pagat e krahasuara, specializimi: Produktiviteti dhe paga); evidenca empirike
<i>Java e katërt:</i>	Tema 4: Modeli standard i tregtisë - Modeli standard i tregtisë, mirëqenia dhe kushtet e tregtisë (raportet e çmimeve eksport/import), Efektet e rritjes ekonomike, efektet e transferimit ndërkombëtar të të ardhurave, efektet e tarifës doganore dhe subvencionit të eksporteve, shpërndarja e të ardhurave
<i>Java e pestë:</i>	Tema 5: Ekonomia e shkallës dhe konkurrenca jo-perfekte - Supozimet e modeleve të deritanishëm (konkurrenca, ekonomia konstante e shkallës); tipet e ekonomisë së shkallës, tipet e konkurrencës jo-perfekte (oligopoli dhe monopoli, konkurrenca monopolistike); konkurrenca monopolistike dhe tregtia, tregtia brenda dhe midis industrive, dumpingu, Ekonomitë e jashtme të shkallës dhe tregtia.
<i>Java e gjashtë:</i>	Tema 6: Lëvizshmëria ndërkombëtare e faktorëve të prodhimit - Lëvizshmëria ndërkombëtare e punës, huamarrja dhe huadhënia ndërkombëtare, investimet e huaja direkte dhe firmat multinacionale.
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i parë (I)
<i>Java e tetë:</i>	Tema 7: Instrumentet e politikës tregtare - Analiza e ekuilibrit të pjesshëm të tarifave: oferta, kërkesa dhe tregtia në një industri të vetme, kostot dhe përfitimet e një tarife, subvencionet e eksportit, kuotat e importit, kufizimet vullnetare të eksporteve, kërkesat për lëndë të para lokale.
<i>Java e nëntë:</i>	Tema 8: Ekonomia politike e politikës tregtare - Argumentet në favor të tregtisë së lirë, argumentet kundër tregtisë së lirë, modelet politike të politikës tregtare, negociatat ndërkombëtare të politikës tregtare dhe Organizata Botërore e Tregtisë.
<i>Java e dhjetë:</i>	Tema 9: Politikat tregtare të vendeve në zhvillim - Industrializimi i zëvendësimit të importit, liberalizimi i tregtisë që nga viti 1985, Industrializimi i orientuar nga eksporti.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Tema 10: Integrimi Ekonomik Rajonal dhe Sistemi Tregtar Multilateral - Integrimi ekonomik dypalësh, rajonal dhe shume palësh: zona e tregtisë së lirë bashkimi doganor, komuniteti ekonomik, Komuniteti Ekonomik Evropian, Marrëveshja e përgjithshme për shërbimet tregtare, Marrëveshje e përgjithshme për tarifat dhe tregtinë, Organizata Botërore e Tregtisë, Sistem i përgjithësuar i preferencave
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Tema 11: Liberalizimi dhe ndihma për tregtinë - Katër

	fushat e Ndhimese për Tregtinë - sfidat nga ana e ofertës (mungesa e dijeve, pengesat administrative, mungesa e financimit adekuat, infrastruktura e varfër); çfarë po ndodh me Ndhimën për Zhvillim; si duhet të funksionojë Ndhimja për Tregtinë - një rol për OBT
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Tema 12: Prezantimet e studenteve për gjetjet hulumtuese
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Tema 13: Prezantimet e Studenteve për gjetjet hulumtuese
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi i dytë (II)

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studentët janë të obliguar të iu përmbahen të gjitha politikave dhe rregullave të mirësjelljes sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës;</p> <p>Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje, dhe të marrin pjesë në çdo aktivitet mësimor</p> <p>Gjatë orëve mësimore nuk lejohet prishja e rendit dhe qetësisë si dhe përdorimi i mjeteve për komunikim.</p> <p>Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.</p> <p>Po ashtu pritet nga studentët që të kryejnë detyrat semestrale me kohë sepse këto janë pjesë e vlerësimit final të notës/kalueshmërisë.</p>	